



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 335/3 Prot.

Tiranë, më 17.07.2020

VENDIM

Nr.72, datë 17.07.2020

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 127, DATË 11.11.2019,
NË INSTITUCIONIN BASHKIA DEVOLL**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 127, datë 11.11.2019, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Devoll, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil, në këtë subjekt”*,

KONSTATOVA SE:

Komisioneri, me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, *“Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”*, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku u përfshi dhe Bashkia Devoll.

Pas përfundimit të mbikëqyrjes, Komisioneri ka dërguar pranë Bashkisë Devoll, vendimin paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë me nr. 127, datë 11.11.2019, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës, si dhe një afat prej 3 (tre) muajsh për zbatimin e tyre.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, Bashkia Devoll ka informuar Komisionerin me shkresën nr. 1226/1prot., datë 05.06.2020, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 335/1 prot., datë 08.06.2020, në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues, duke bashkëngjitur një pjesë të dokumentacionit që provon zbatimin e tij. Gjithashtu, njësia përgjegjëse, në rrugë elektronike, në datën 09.07.2020, ka dërguar pjesën e dokumentacionit që mungonte në shkresën e sipërpërmendur dhe që vërteton zbatimin e plotë të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrur, Bashkia Devoll, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim.

Konkretisht:

1. Kryetari i Bashkisë Devoll, me aktin nr. 13, datë 21.01.2020, ka urdhëruar lirimimin nga detyra të punonjësit *****, i emëruar në kundërshtim me ligjin në pozicionin e punës “*Drejtor në Drejtorinë e të Ardhurave, Licensimit dhe Menaxhimit Financiar*” .
2. Njësia përgjegjëse, me aktin nr. 823 prot, datë 10.03.2020, ka miratuar planin vjetor të pranimin në shërbimin civil për vitin 2020, dhe, njëkohësisht, ka dërguar për publikim pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit shpalljet e vendeve vakante për t’u plotësuar nëpërmjet procedurave të konkurrimit në përputhje me vendimin nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për planin vjetor të pranimin në Shërbimin civil*”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 127, datë 11.11.2019, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Devoll, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil, në këtë subjekt”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Bashkia Devoll.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Bashkia Devoll.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha